



UNIVERSITY OF UTAH
SCHOOL OF MEDICINE

KARTA e të DREJTAVE TË PJESËMARRËSIT NË HULUMTIM

Çdo person ka të drejta. Hulumtuesit në Universitetin e Utah dëshirojnë që ju të jeni të vetëdijshëm për të drejtat tuaja.

Ju apo i afërmi juaj keni të drejtë:

T'ju thuhet pse po kryhet studimi hulumtues.

T'ju thuhet se çfarë do tëndryshojë nga kujdesi juaj i zakonshëm dhe çfarë do të jetë e njëjtë.

T'ju thuhet se cilët janë rreziqet dhe efektet anësorë, duke përfshirë çdo pakënaqësi.

T'ju thuhet nëse ka ndonjë përfitim nga pjesëmarrja juaj në studimin hulumtues dhe cilat janë këto përfitime.

T'ju thuhet të GJITHA opsionet bashkë me rreziqet dhe përfitimet e tyre.

T'ju thuhet se çfarë kujdesi mjekësor është i disponueshëm për ju në rast lëndimi apo komplikacione nga pjesëmarrja në studimin hulumtues.

Të keni kohë për të vendosur nëse pjesëmarrja është gjëja e duhur për ju.

Të keni kohë për të bërë pyetje para dhe gjatë studimit hulumtues.

Të zgjidhni të MOS merrni pjesë në studimin hulumtues në çdo moment. E drejta juaj për kujdes mjekësor NUK do të ndikohet nëse vendosni të mos merrni pjesë në studimin hulumtues.

Të merrni vendimin tuaj pa presion apo sforcim.

T'ju jepet një kopje me datë dhe e firmosur e formularit të miratimit.



Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim në lidhje me të drejtat tuaja, apo të drejtat e të afërmit tuaj, ju lutemi kontaktoni doktorin tuaj të hulumtimit.

Ju gjithashtu mund të kontaktoni Universitetin e Utah Bordin e Rishikimit Institucional (BRI) [Institutional Review Board (IRB)] në numrin (801)581-3655 ose Avokatin e Pjesëmarrësit në Hulumtim në numrin (801)581-3803.

